REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 639/20
Datë/Datum. 07/09/2020
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: KUVENDI KOMUNAL-DEÇAN

Nr[1] i prokurimit	**631-20-1872-2-2-1**
Nr i brendshëm	**631 20 016 221**

Sa i përket tenderit për: **Hartimi-përpilimi i projekteve ideore dhe zbatuese**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

"AL Engineering" shpk
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr.Mujë Krasniqi C7H11Nr14, Prishtinë
(Adresa)

Prishtinë
(Vendi)

10000
(Kodi postar)

044 200285
(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Sami Lokaj
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

bejtacommerce@gmail.com
(Adresa elektronike)

07.09.2020
(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

SH.P.K. L.L.C AL ENGINEERING PRISHTINE

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

[1] Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar "Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontratë: 08.05.2020 Afati i fundit për dorëzimin e tenderit: 08.06.2020 Njoftimi mbi vendimin e AK-së: 20.08.2020 Kërkesa për rishqyrtim me dt:25.08.2020 Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim me dt: 26.08.2020

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ **Jo** ☐

SH.P.K. LLC AL ENGINEERING PRISHTINE

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] **Jo** [ ]

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 64 i LPP-së
Neni 69 i LPP-së

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Me dt. **20.08.2020** përmes platformës elektronike e-prokurimi jemi njoftuar me njoftimin mbi vendimin e AK-së ku është rekomanduar për kontratë "PROing&Partners" SH.P.K & Fidan Hasaj B.I & ARTING PROJECT SH.P.K, ndërsa ne jemi njoftuar me letrën standarde për tenderues të eliminuar.

Sa për informimin tuaj, procesi i tenderit ka shkuar mire deri ne momentin kur Komuna e Deçanit e kanë anuluar tenderin me dt. 23.06.2020 sipas nenit 35.2.1 – arsye objektive dhe te detyrueshme teknike ose estetike, pastaj te nesërmen e sjellin edhe një vendim tjetës për anulim neni 62.1 .1 te LPP me sqarimin se paramasa dhe parallogaria ka gabime te pa riparueshme pasi kolona ri-projektimit duhet te largohet për veç një pozicioni. Që i bie qe ne ofertuesve na ka qitë ne lajthitje

AL ENGINEERING PRISHTINË

pasi kolona e ri-projektimit nuk ka qenë e vendosur fare ne llogari (ne formulat e mbledhjes), ndërsa vetëm ofertuesit qe kanë pasur informata nga brenda e kanë plotësuar ketë pozicionin (me çmime te lartë) e vetëm te kolonës te ri-projektim (qe shihet nga çmimet e ofertuesve). Pra këtu ka pasur një lloj kurdisje nga ana e AK-së.

Siç u ceke procesi ka shkuar ne rregull deri ne datën e pezullimit të aktivitetit të prokurimit, ku AK-ja paraprakisht ka kërkuar sqarim për çmimin normalisht jo te ulet, pastaj kanë kërkuar sqarim për licencën e softwerit te projektimit te infrastrukturës për te dyjat ju kemi përcjellje sqarim zyrtare.

Ngjashëm kanë vepruar edhe vitin e kaluar, edhe tani ne ketë vit, zyra e prokurimit te Komunës se Deçanit po e dëmtojnë procesin e tenderit, po e anulojnë tenderin pasi po dihen çmimet e se cilit ofertues dhe po vazhdojnë me ri-tender me te njëjtën paramasë dhe parallogari dhe çmimet pastaj dihen se po bëhen publike. Qe ne mendojmë qe kjo është pa-përgjegjësi dhe shkelje ligjore dhe mendojmë se bahet me qellim pasi kompania jonë po delë me ofertë me te lirë.

Pas anulimit kompania jonë ka kërkuar zyrtarisht AK qe te rishqyrtohet ky vendim por AK-ja e ka refuzuar zyrtarisht.

Po ashtu edhe konzorciumi "PROing&Partners" SH.P.K & Fidan Hasaj B.I & ARTING PROJECT SH.P.K kishte parashtruar kërkesë për rishqyrtim mirëpo përgjigja e kthyer nga AK-ja shihet që ky konzorcium ka pasur informata nga zyrtaret e AK-së në procesin e brendshëm te vlersimit (që kjo është jo ligjore) dhe po ashtu duke u bazuar edhe nga kjo shkresë shihetë se AK-ja pasi ka përfunduar të gjitha proceset e vlerësimit ka pasur një presion të brendshëm dhe ka anuluar tenderin duke bere një veprim jo-ligjor.

Pastaj konzorciumi "PROing&Partners" SH.P.K & Fidan Hasaj B.I & ARTING PROJECT SH.P.K ka parashtruar ankesë në OSHP dhe lënda është kthyer në Ri-vlerësim.

SH.P.K. L.L.C. AL ENGINEERING PRISHTINË

Ju sqarojmë se ne jemi diskriminuar në këtë aktivitet të prokurimit, sepse ju keni rekomanduar për kontratë një OE i cili është i papërgjegjshëm për arsyet si në vijim:

OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm për faktin se anëtari i konzorciumit Fidan Hasaj B.I. nuk i plotëson të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë përkatësisht kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare neni 8.1&8.2 ku kërkesë ka qenë "*Kërkesa 1 Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve te shkuara nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, në vlerë jo më pak se 240,000.00 € (ne rast konzorciumi 2 /3 e vlerës për liderin)*, ndërsa si dëshmi është kërkuar "*Deklaratat Tatimore vjetore të dorëzuara në ATK për tri vitet e shkuara nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë.*
Anëtari i konzorciumit i lartcekur është i papërgjegjshëm se nuk i ka dorëzuar fare deklaratat vjetore tatimore për vitin 2019, andaj kërkesa e lartpërmendur nuk është përmbushur dhe OE i rekomanduar për kontratë është dashur të shpallet i papërgjegjshëm.

Grupi i OE të rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm edhe për faktin se anëtari tjetër i konzorciumit ARTINGS PROJECT SH.P.K nuk ka ofruar dëshmi për qarkullim financiar dhe mundësitë teknike - profesionale, andaj edhe është dashur të shpallet i papërgjegjshëm ky grup i OE dhe jo të rekomandohet për kontratë.

Diploma e inxhinierit ndërtimtarisë Diamanti Kabashi është e pa noterizuar, ndërsa në FDT shkruan qartë tek dëshmia e kërkuar se diplomat në lidhje me stafin profesional duhet të jenë të noterizuara.

OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm edhe për faktin se inxhinieri i prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë Enver Gashi nuk ka referenca në hartim të projekteve (që e tregojnë përvojën e punës së kërkuar) pas diplomimit.

Po ashtu OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm edhe për faktin se anëtari i konzorciumit "PROing&Partners" SH.P.K nuk i plotëson të gjitha kërkesat e FDT-së përkatësisht Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale - Kërkesa 7. *Një Inxhinier i Diplomuar i Infrastrukturës ose master i Infrastrukturës*, ndërsa si dëshmi është kërkuar "*Për stafin profesional duhet te prezantohen • Diplomat-kopje të noterizuara (te diplomuarit jashtë vendit diploma te jetë e nostrifikuar ne Kosovë).*
Në bazë të nenit 3, pika 16.1 UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MAShT) Nr. 12-2018 (PARIMET DHE PROCEDURAT E NJOHJES SE DIPLOMAVE GRADAVE DHE KUALIFIKIMEVE TË SHKOLLAVE TË LARTA PROFESIONALE DHE UNIVERSITARE TË FITUARA JASHTË REPUBLIKËS SË KOSOVËS) diplomat e ish-Jugosllavisë njihen deri 1990 (ka rrjedhe një gabim ne gjuhen Shqipe është 1992, edhe ne rregulloren paraprake 16-2016 te nenin 3, pika 17.1, ne tri gjuhet zyrtare ka qenë deri 1990) edhe nëse njihen diplomat e ish-Jugosllavisë deri 1992 kjo nuk vlen për shtetin e Maqedonisë se Veriut pasi ajo nuk është pjesë e Jugosllavisë nga 1991 (me saktësisht dita pavarësisë se Maqedonisë është 8 shtator 1991).
Anëtari i këtij grupi OE PROing&Partners" SH.P.K ka ofruar inxhinierin e ndërtimtarisë-drejtimi infrastrukturë Shaban Idrizi, i cili inxhinier është i diplomuar ne Maqedoni ne vitin 1992 dhe diploma e tij është e pa nostrifikuar d.m.th. OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson ketë kriter dhe është dashur të shpallet i papërgjegjshëm.

SH.P.K, L.L.C. AL ENGINEERING PRISHTINË

- Në lidhje me arsyen tonë të eliminimit ku e keni cekur se *"Gabimi artimetikor i evidentuar është më shumë se dy përqind (2%) i vlerës totale të ofertës"*, ju sqarojmë se kjo arsye nuk qëndron për arsyet si në vijim:

Në vijim po e paraqesim tabelën me çmime e cila tregon se ne nuk kemi bërë ndonjë gabim artimetikor:

SH.P.K. L.L.C AL ENGINEERING PRISHTINË

HARTIMI I PROJEKTEVE

A	Rrugët, Objekte të rrugës, Matje Gjeodezike, Elaborate, Plane rregullative dhe Hapësira Publike	Njesia matese	Projekt i Ri	Ri- Projektim	Sipas tenderit Totali i projektimit per rrugët, objektet e rrugës dhe hapsëirat publike (33 % e pikeve ne vleresim)	Me mbledhjen e ri-projektimit Totali i projektimit per rrugët, objektet e rrugës dhe hapsëirat publike (33 % e pikeve ne vleresim)
1	Hartimi I Projektit Kryesor Zbatues, i rrugëve në pjesën urbane - me dy kursi	m'	€ 0.03	€ 0.01	€ 0.01	€ 0.01
2	Hartimi i Projektit Kryesor Zbatues i shtegut për biciklist në zonën Urbane	m'	€ 0.03	€ 0.01	€ 0.01	€ 0.01
3	Hartimi i Projektit Kryesor Zbatues, i rrugëve në pjesën rurale - me dy kursi	m'	€ 0.03	€ 0.01	€ 0.01	€ 0.01
4	Hartimi i Projektit Kryesor Zbatues, i shtegut për biçiklist në zonën Malore	m'	€ 0.03	€ 0.01	€ 0.01	€ 0.01
5	Hartimi i Projektit Kryesor Zbatues, i trotuareve në zonën Urbane dhe Rurale	m'	€ 0.03	€ 0.01	€ 0.01	€ 0.01
6	Hartimi I planit rregullatib për Bjeshken e Belegut	m²	€ 0.03	€ 0.01	€ 0.01	€ 0.01
7	Matjet gjeodezike për kufive kadastral të pronave, rrugëve,trotuarëve, shtigjeve pë biçiklist dhe kanaleve të ujitëjes	m'	€ 0.45	€ 0.01	€ 0.15	€ 0.15
8	Matjet gjeodezike i Sipërfaqeve të pronave Komunale dhe Private	m²	€ 0.03	€ 0.01	€ 0.01	€ 0.01
9	Hartimi i Projektit Kryesor Zbatues, i Urave deri 10 m	m'	€ 0.03	€ 0.01	€ 0.01	€ 0.01
10	Hartimi i Projektit Kryesor Zbatues, i Urave mbi 10 m	m'	€ 0.03	€ 0.01	€ 0.01	€ 0.01
11	Hartimi i Projektit Kryesor, Zbatues i Mureve Mbrojtëse	m'	€ 0.03	€ 0.01	€ 0.01	€ 0.01
12	Hartimi i Projektit Kryesor, Zbatues i parkingjeve	m²	€ 0.03	€ 0.01	€ 0.01	€ 0.01
13	Hartimi i Projektit Kryesor, Zbatues i parqeve dhe sheshe	m²	€ 0.03	€ 0.01	€ 0.01	€ 0.01
14	Hartimi i elaborateve për VNM	m²	€ 0.03	€ 0.01	€ 0.01	€ 0.01
15	Hartimi i elaborateve të shpronsimit (elaboratet e shpronesimit)	m²	€ 0.03	€ 0.01	€ 0.01	€ 0.01
16	Shqyrtime Gjeomekanike - Shpimet dhe studimet gjeomekanike dhe përgatitja e elaboratit gjeomekanik.	m'	€ 0.03	€ 0.01	€ 0.01	€ 0.01
					€ 0.30	€ 0.30

B	Infrastruktura hidroteknike	Njesia matese	Projekt i Ri	Ri- Projektim	Totali i projektimit per rrugët, objektet e rrugës dhe hapsëirat publike (34 % e pikeve ne vleresim)	Totali i projektimit per rrugët, objektet e rrugës dhe hapsëirat publike (34 % e pikeve ne vleresim)
1	Hartimi i Projektit Kryesor, Zbatues i Kanalizimit Atmosferik ne zona Urbane	m'	€ 0.03	€ 0.01	€ 0.01	€ 0.01
2	Hartimi i Projektit Kryesor, Zbatues i Kanalizimit Atmosferik ne zona Rurale	m'	€ 0.03	€ 0.01	€ 0.01	€ 0.01
3	Hartimi i Projektit Kryesor, Zbatues i Rrjetit te Ujësjellsit në Bjeshkë e Deçanit	m'	€ 0.03	€ 0.01	€ 0.01	€ 0.01
	Projekti i Rezervave të ujit për pije në Bjeshkë të Deçanit	m²	€ 0.03	€ 0.01	€ 0.01	€ 0.01
5	Hartimi i Projektit Kryesor, Zbatues i Kanalizimit Fekal në zonën Rurale (Ri - Projektim)	m'	€ 0.03	€ 0.01	€ 0.01	€ 0.01
	Hartimi i Projektit Kryesor, Zbatues i Kanalizimit Fekal në zonën Rurale (Projekt i Ri)		€ 0.03	€ 0.01	€ 0.01	€ 0.01
6	Hartimi i Projektit Kryesor, Zbatues i Kanalizimit Fekal në zonën Urbane (Ri - Projektim)	m'	€ 0.03	€ 0.01	€ 0.01	€ 0.01
7	Hartimi i Projektit Kryesor Zbatues, i shtratit të perroit	m'	€ 0.03	€ 0.01	€ 0.01	€ 0.01
8	Hartimi i Projektit Kryesor Zbatues, i shtratit të lumit	m'	€ 0.03	€ 0.01	€ 0.01	€ 0.01
9	Hartimi i Projektit Kryesor Zbatues, i Rezervave te Ujitë (Kaptazhes) për ujësjellsin e Qytetit	m²	€ 0.03	€ 0.01	€ 0.01	€ 0.01
10	Hartimi i Projektit Kryesor Zbatues, i rregullimir të hapësirave për rreth Rezervave të ujitë (Kaptazhav)	m²	€ 0.03	€ 0.01	€ 0.01	€ 0.01
11	Hartimi i Projektit Kryesor Zbatues, i Pendave te Ujitë në shtratin e lumit për furnizimin e kanaleve të ujitëjes më ujë për tokat bujqësore.	m'	€ 0.03	€ 0.01	€ 0.01	€ 0.01
12	Hartimi i Projektit Kryesor Zbatues, i impiantev për trajtimin e ujrave te zeza prej 500-9000 banor	m²	€ 0.03	€ 0.01	€ 0.01	€ 0.01
13	Hartimi i Projektit Kryesor Zbatues, i impiantev për trajtimin e ujrave te zeza prej 9000-20000 banor	m²	€ 0.03	€ 0.01	€ 0.01	€ 0.01
14	Hartimi i Projektit Kryesor Zbatues i Kanaleve Ujitëse me elemente përcjellese	m'	€ 0.03	€ 0.01	€ 0.01	€ 0.01
	B - gjithsejt (1-15):				€ 0.15	€ 0.15

SH.P.K. L.L.C. AL ENGINEERING PRISHTINË

C	Ndërtim i Lartë	Njesia matese	Projekt i Ri	Ri- Projektim	Totali i projektimit per rrugët, objektet e rrugës dhe hapsëirat publike (33 % e pikeve ne vleresim)	Totali i projektimit per rrugët, objektet e rrugës dhe hapsëirat publike (33 % e pikeve ne vleresim)
1	Hartimi i Projektit Kryesor Zbatues, i objekteve deri në 500 m²	m²	€ 0.03	€ 0.01	€ 0.01	€ 0.01
2	Hartimi i Projektit Kryesor Zbatues, i objekteve 500-2000 m²	m²	€ 0.03	€ 0.01	€ 0.01	€ 0.01
3	Hartimi i Projektit Kryesor Zbatues, i objekteve mbi 2000 m²	m²	€ 0.03	€ 0.01	€ 0.01	€ 0.01
4	Hartimi i Projektit Kryesor Zbatues, për renovimin e objekteve institucionale		€ 0.03	€ 0.01	€ 0.01	€ 0.01
5	Hartimi i Projektit Kryesor Zbatues, i instalimeve elektrike në objektet e institucioneve Komunale	m²	€ 0.03	€ 0.01	€ 0.01	€ 0.01
6	Hartimi i Projektit Kryesor Zbatues, i instalimeve të ujësjellsit dhe kanalizimit në objektet e institucioneve Komunale	m²	€ 0.03	€ 0.01	€ 0.01	€ 0.01
7	Hartimi i Projektit Kryesor Zbatues, për Memoriale	m²	€ 0.03	€ 0.01	€ 0.01	€ 0.01
8	Hartimi i Projektit Kryesor Zbatues, për varreza të Dëshmorve	m²	€ 0.03	€ 0.01	€ 0.01	€ 0.01
	C- Gjithësej (1-8)				€ 0.08	€ 0.08

REKAPITULLIM

Situacionet	Çmimi total i peshuar	Çmimi
A - Gjithsej (1-16):	€ 0.30	€ 0.30
B - Gjithsej (1-14):	€ 0.15	€ 0.15
C- Gjithësej (1-8)	€ 0.08	€ 0.08
Çmimi i Pergjithshem i peshuar (ofertat do te vleresohen ne baze te kesaj vlere). Kjo është vlera e cila do te duhet te shenohet ne Formularin e ofertes dhe do te lexohet gjate hapjes publike.	€ 0.53	€ 0.53

Te pjesa A dhe C e paramasës:

- Kur e shumëzon çmimin njësi sipas dosjes 0.03 x 33% = 0.099€ (pasi duhet te jetë dy shifra pas zeros - rrumbullakohet 0.01€) – sipas dosjes se tenderit
- Ne rastin kur e mbledhim ri-projektimin (0.03+0.01) x 33% = 0.0132€ (pasi duhet te jetë dy shifra pas zeros - rrumbullakohet 0.01€) – ne kundërshtim me dosjen e tenderit

E njëjta vlen edhe te pozicioni A.7 - 0.45 x 33%=0.1485 € (pasi duhet te jetë dy shifra pas zeros - rrumbullakohet 0.15€) – sipas dosjes se tenderit

Me rastin e mbledhjes se Ri-projektimit, te pozicioni A.7 – (0.45+0.01) x 33%=0.1518 € (pasi duhet te jetë dy shifra pas zeros - rrumbullakohet 0.15€) – ne kundërshtim me dosjen e tenderit

Rasti te pjesa B e paramasës:

- Edhe te kjo pjesë është e njëjta, 0.03 x 34% = 0.0102 (pasi duhet te jetë dy shifra pas zeros - rrumbullakohet 0.01) – sipas dosjes se tenderit.
- Edhe ne rastin kur e mbledhim ri-projektimit (0.03+0.01) x 34% = 0.0136 (pasi duhet te jetë dy shifra pas zeros - rrumbullakohet 0.01) – ne kundërshtim me dosjen e tenderit.

Andaj duke u bazuar në faktet e lartpërmendura shihet qartë se nuk egziston ndonjë gabim aritmetikor siç ka pretenduar AK dhe është dashur të shpallemi si tenderues i suksesshëm dhe jo të eliminohemi nga ky aktivitet i prokurimit pa ndonjë arsye konkrete.

Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë që u cekën më lartë, rezulton se konzorciumi i rekomanduar për kontratë nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë, prandaj sipas paragrafit 4 të nenit 59 të LPP-së, ky konzorcium është i papërgjegjshëm.

S.H.P.M. L.L.C AL ENGINEERING PRISHTINË

Ne me dt. 26.08.2020 kemi pranuar vendimin e AK-së mbi refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim, në të cilin vendim AK-ja si arsyetim i ka dhënë arsyet e njëjta sikurse në njoftimin mbi vendimin e AK-së. Arsyetim ky që tregon se pretendimet tona ankimore janë të bazuara.
Po ashtu edhe ne ketë shkresë ka shkelje ligjore data kësaj shkrese është e shenuar 26.05.2020.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë **tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.**

Gjithashtu nuk është respektuar edhe neni 7 i LPP-së, sepse nuk jemi trajtuar në mënyrë të barabartë me OE fitues.

Gjithashtu nuk është marr në konsideratë edhe neni 1 i LPP-së, sepse qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Krejt në fund kërkojmë nga OSHP që të nxjerr Vendim për aprovim të ankesës tonë dhe ta kthej në rivlerësim këtë aktivitet të prokurimit dhe rivlerësimi të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, në vlerë prej 5,000.00 euro.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*

AL ENGINEERING PRISHTINË